




REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. <u>2-D/DPK</u>	Nr. Prot. Bi Prot. <u>01-2087/2012</u>
Nr. Flag Broj stranica <u>02</u>	Data Datum <u>13-06-2012</u>
Nr. pages	Date
PRISHTINE	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika d) si dhe 29.3 të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 24.05.2012, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllët rasti me nr. AKK- 03-537/12, për, z. Zyrtarin e Lartë, z.Naser Bajraktari, Drejtor i Departamentit te Ujërave ne Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë, për shkak se nuk ka të dhëna të mjaftueshme që argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të mundshëm te interesit, që për trajtim ka pasur Zyrtarin e Lartë, z.Naser Bajraktari, Drejtor i Departamentit te Ujërave ne ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë.

Gjate zhvillimit të procedurës dhe analizimit të gjendjes është konstatuar se zyrtari e lartë, gjatë kohës se ushtrimit të funksionit publik si, Drejtor i Departamentit te Ujërave ne Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë, njëkohësisht ka qene duke ushtruar edhe një tjetër funksion publik si Kryetar i Bordit ne K.R.U "Hidroregjioni Jugor" Prizren.

Agjencia kundër Korrupsionit me datën 30.03.2012, e ka njoftuar zyrtarin e Lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejte në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet qe posedon Agjencia.

Pas këtyre procedurave, z.Naser Bajraktari, pasi ka kontaktuar me zyrtaret e Agjencisë dhe ka ardhur te ballafaqohet me faktet qe posedon Agjencia, gjate takimit qe është mbajtur ne zyrat e AKK-së është biseduar për gjendjen dhe faktet qe disponon Agjencia lidhur me konfliktin e mundshëm të interesit, gjate ushtrimit te funksionit Publik. z.Naser Bajraktari, i ka njoftuar zyrtaret e Agjencisë me detyrat dhe përgjegjësit e tij ne Funksionin Publik si Drejtor i

Departamentit të Ujërave në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë ku punon që nga viti 2009, si dhe me punën tjetër dytësore (honorarit) si Kryetar i Bordit në K.R.U “Hidroregjioni Jugor” Prizren I zgjedhur me konkursin publik të para parë sipas ligjit Nr.03/L-087 mbi ndërmarrjet Publike, aje ndër të tjera ka theksuar se edhe në momentin e zgjedhjes së tij si Anëtar i Bordit është konsultuar me hierarkinë e tij, ku punon ku I është thënë se nuk ka gjendje të konfliktit të interesit, po ashtu është konsultuar edhe me partneret që e kanë përkrahur K.R.U “Hidroregjionin Jugor” Prizren, si USAIDI etj.

z.Naser Bajraktari potencon se asnjë herë në asnjë moment gjatë kohës sa ushtron pozitën e drejtorit të Departamenti nuk ka qenë në pozitën që mundë të sillte në situatë të konfliktit të interesit dhe mundë të kenë ndonjë lidhje me punën dytësore si Kryetar i Bordit në K.R.U “Hidroregjioni Jugor” Prizren, pasi që të gjitha aktivitetet dhe punët mbikëqyrën dhe aprovohen nga Sekretari i Përgjithshëm i kësaj Ministrie dhe mendon se nuk gjendet në situatën e Konfliktit të Interesit.

Me datën 03.05.2012 në adresë të Agjencisë Kundër Korrupsionit ka ardhur një Shkresë nga Sekretari i përhershëm i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë, ku e informon Agjencinë pas kërkesës së bërë nga z.Naser Bajraktari, për ta informuar Agjencinë lidhur me detyrat dhe përgjegjësit në ushtrimin e funksionit të tij si Drejtor i Departamentit të Ujërave në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë.

Duke u bazuar nga faktet dhe gjendja reale si dhe në Ligjin Nr.04/L-051, Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, nenin 15.2 ku thuhet se: Zyrtari i lartë në cilësinë e anëtarit të organit drejtues të ndërmarrjes në pronësi publike apo shoqërisë aksionare me pronë publike, mirëpo nuk ka të drejtë kompensimi me pagë të rregullt, përveç të drejtës në kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe shpenzimeve tjera të nevojshme.

Konstatohet se: z.Naser Bajraktari nuk është në gjendje të Konfliktit të Interesit dhe nuk ka mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit Publik të Para parë sipas Ligjit Nr.04/L-051, Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, pasi që pozita e tij si Kryetar i Bordit në K.R.U “Hidroregjioni Jugor” Prizren, është punë dytësore, sekondare me Honorarë dhe nuk paguhet, me rroge të përhershme por i paguhet vetëm mëditjet për takimet e mbajtura.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Hasan Preteni
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

